



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 6 MARS 2023**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 6. MARTA 2023. GODINE**

**MARS - MART
2023**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 25-vjetorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Dnevni red

1. Obeležavanje 25-godišnjice Epopeje Oslobodilačke vojske Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani-Sadriu,
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Albin Kurti,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Shumë e nderuara familje e komandantit legjendar Adem Jashari,
I dashuri Baca Rifat,
Të nderuar ambasadorë të pranishëm,
Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier
I nderuari përfaqësues i Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës, Tomas Sunjog,
Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare,
Të nderuar zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se erdhët në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të 25-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ju lus, që tash që të ngrihemi në këmbë dhe ta nderojmë himnin shtetëror të Republikës së Kosovës e pastaj edhe atë kombëtar shqiptar.

(Intonimi i himnit shtetëror dhe atij kombëtar)

KRYETARI: Falënderojmë pjesëtarët e Filharmonisë për interpretimin e himneve tona!
Tash po ju lus, të nderuar, që me një minutë heshtje t'i nderojmë të gjithë të rënë për Lirinë dhe Pavarësinë e Republikës së Kosovës.

(Një minutë heshtje)

Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe të rënëve për Lirinë e Kosovës!

Tash e ftoj presidenten e Republikës së Kosovës, shkëlqesinë e saj Vjosa Osmani-Sadriu, që me një fjalë rasti t'i drejtohet Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Urdhëroni, zonja presidente!

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI-SADRIU: I nderuar kryetar i Kuvendit, z. Konjufca,
I nderuar kryeministër i Republikës, z. Kurti,
Shumë i dashur Baca Rifat,

Të nderuar përfaqësues të Familjes Jashari që na keni nderuar me praninë tuaj në këtë seancë,

Të nderuar deputetë, përfaqësues të tjerë të institucioneve qendrore dhe lokale të Republikës,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike,

Të nderuar komandantë dhe oficerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

Të nderuar veteranë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Çdo fillimmars vështrimi ynë qytetar dhe institucional kthehet kah ngjarjet historike, të cilat kanë shënjuar një kthesë vendimtare për kombin tonë dhe janë ngulitur fort në kujtesën e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këto ngjarje janë pjesa më e rëndësishme e trashëgimisë sonë historike, mbi të cilën ne e shtresojmë secilën përpjekje tonën për ta konsoliduar shtetin tonë, për të cilin breza të tërë sakrifikuan edhe më të shtrenjtën e tyre: jetën.

Ngjarjet e 5, 6 e 7 marsit të vitit 1998 përbëjnë jo vetëm kujtesën tonë për historinë më të re të Kosovës, por edhe njërën ndër shtyllat më të forta mbi të cilat u ngrit shteti ynë i ri, Republika e Kosovës.

Kushtrimi i dhënë më 5 mars nga komandanti legjendar Adem Jashari bashkë me familjen e tij ishte kushtrimi i mobilizimit të vajzave e djemve të UÇK-së, të cilët përgjatë tri ditëve të betejës në Prekaz në një përballje heroike me forcat e regjimit gjenocidal të Serbisë fituan përjetësinë.

Kjo Epope e UÇK-së është epope e dinjitetit, e krenarisë dhe e lirisë sonë.

Në këtë betejë të lavdishme u përjetësua vendosmëria e familjes Jashari dhe e gjithë luftëtarëve të UÇK-së, për ta mbrojtur çdo pëllëmbë të kësaj toke sikurse edhe për ta përlligjur sakrificën ndaj atdheut si sakrificën më sublime të njeriut.

Në këto ditë të lavdisë, në njërën anë ishte Baca Shaban, Hamza, Komandanti Legjendar Adem Jashari, familjarët dhe bashkëluftëtarët e UÇK-së që personifikonin të drejtën dhe lirinë, teksa nga ana tjetër ishin forcat gjenocidale serbe, të cilët u bindën se liria është më e çmueshme se çfarëdo fuqie e tyre ushtarake.

Fakti se makineria vrasëse serbe nuk i kurseu as fëmijët, pleqtë e gratë, se nuk kurseu askë e asgjë, ia dëshmon historisë të drejtën e popullit tonë për t'u mbrojtur dhe për ta arritur lirinë.

Në këtë ditë kujtojmë edhe të gjitha gratë dhe fëmijët e Familjes Jashari, të cilët nuk i kurseu regjimi gjenocidal i Serbisë. Kujtimi për ta dhe sakrificën e tyre do të jetë i përjetshëm për të gjithë Kosovën, e cila sot është e lirë pikërisht falë kësaj sakrifice. Në ditë si këto duhet të kujdesemi gjithëherë që fëmijëve tanë, e brezave që do i lëmë pas t'ju flasim për fëmijët e Jasharajve dhe për të gjithë fëmijët që ranë në altarën e lirisë, si dhe për shembullin e trimërisë e guximit që e dha e gjithë Familja Jashari e udhëhequr nga Komandanti Legjendar.

Prandaj, sot, një çerekshekulli më pas, ne e kujtojmë me përvullë sakrificën kësaj familjeje, të burrave e grave, fëmijëve e pleqve, dhe të gjithë dëshmorëve, të cilët ranë theror në atë betejë dhe beteja të tjera, për t'u shndërruar shpejt në simbol të rezistencës sonë për liri. Po kështu, u jemi mirënjohës përjetësisht gjithë burrave e grave të UÇK-së, të cilët i dolën zot atdheut e ranë për lirinë e tij, duke u shndërruar në pjesën më të lavdishme të historisë sonë. Ata dëshmuar se përballë dhunës së skajshme, gjithmonë forcohet skajshmërisht ndjenja për lirinë; përballë synimit për ta shfarosur apo dëbuar një popull të tërë, bëhet e pamposhtur bindja e tij për të jetuar i lirë.

Të dashur qytetarë të Republikës!

Të nderuar deputetë!

E nderuar Familje Jashari!

Sikurse dëshmohet në histori, një çerekshekull nuk është shumë i gjatë në jetën e popujve e të shteteve. Mirëpo, ai mund të tingëllojë i gjatë nga pikëvështrimi kohor. Prandaj, është shumë e rëndësishme për ta mbajtur të gjallë kujtesën për rrugën tonë. Nuk thuhet kot se popujt të cilët e harrojnë historinë e tyre, rrezikojnë t'i nënshtrohen përsëritjes së saj.

Prandaj, ne duhet e do ta mbajmë të gjallë kujtesën për sakrificën e Familjes Jashari dhe për gjithë luftën e UÇK-së, të cilën ata e bënë për vendin. Ne duhet ta ruajmë kujtesën për rezistencën e kësaj familjeje të prirë nga komandanti legjendar Adem Jashari, por edhe sakrificën e një populli të tërë, si pjesë të historisë sonë të dhimbshme, ngase duke i kujtuar ata, ne e shtresojmë rrëfimin tonë për vetveten e për rrugën të cilën e kemi kaluar deri në krijimin e shtetit të lirë e të pavarur të Kosovës.

Ne e fituam lirinë, sepse e njohëm peshën e saj për shekuj, duke u përballur shpesh me mungesën e saj për shkak të mësymjeve të ndryshme ndaj nesh. Por, ne e fituam atë edhe sepse në rrethana të vështira historike ne qëndruam, e përballuam dhimbjen, e luftuam të bindur në fitoren përfundimtare. Lirinë, sikur dihet, e fitojnë ata popuj e ato vende që besojnë vërtet në të dhe që janë të gatshëm t'i bëjnë ballë secilës sakrificë për ta arritur këtë. Ne, që e kemi provuar shtypjen, e dimë më se miri këtë.

Këtë më së miri e kishte kuptuar edhe prijësi i luftës sonë për çlirim, komandant Adem Jashari, i cili bashkë me luftëtarë të tjerë të UÇK-së, përgatitjet për përballjen përfundimtare me Serbinë i kishte nisur qysh më 1991 në Shqipëri.

Ai e dinte se mbi supe po merrte rreziqe të mëdha, se gatishmëria e tij për sakrificë sublime mund të bëhej edhe sakrificë e familjes, se mund t'i kërkohej që fatit të vendit t'ia falte fatin e vet. Por, ai ishte i vendosur. Rrethimin nuk mund ta duronte, duhej çarë atë, ngase ndjenja e lirisë nuk mund të mbahej më e rrethuar. Ai u sfidua me rrethimin e familjes edhe më 30 dhjetor 1991, e më 22 janar 1998, para se të binte në betejën vendimtare të marsit 1998, së bashku me shumicën e anëtarëve të familjes së tij.

Të dashur qytetarë!

Beteja e Jasharajve u shndërrua në frymëzim për mijëra të rinj e të reja, të cilët, të nxitur nga jehona e ngjarjeve të Prekazit i dolën zot tokës së tyre, vendit të të parëve. Por, beteja e Jasharëve po ashtu ndihmoi edhe në mobilizimin e bashkësisë ndërkombëtare rreth çështjes së Kosovës. Pamjet e fëmijëve, të grave e të pleqve, të vrarë në pragun e shtëpisë së tyre, nuk mund të kaloheshin heshtur nga diplomacia botërore. Ato u shndërruan në thirrje për t'i mbrojtur vlerat njerëzore sikurse edhe vlerat e qytetërimit evropian.

Komandanti Legjendar u ngrit, vuri në gatishmëri veten dhe familjen për t'u bërë pastaj emblemë e përhershme e lirisë sonë.

Ai është personifikim i heroizmit, i sakrificës, dy virtyte fisnike, të cilat i garantojnë përjetësinë e neve na garantuan lirinë.

Le të frymëzohemi nga shembulli i tij dhe i gjithë luftëtarëve të UÇK-së, e le të përpiqemi t'i mishërojmë këto virtyte në jetën tonë dhe për shtetin tonë.

Përfundimisht ne jemi të lirë, e Ai është i gjallë!

Zoti e bekoftë Familjen Jashari!

Zoti i bekoftë dëshmorët dhe heronjtë e UÇK-së!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj! Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, presidente! Tash më lejoni që të ju drejtohem me një fjalë të rastit.

KRYETARI I KUVENDIT, GLAUK KONJUFCA: Të nderuar anëtarë të Familjes së madhe Jashari,
I dashuri Baca Rifat,
Të nderuar deputetë,
E nderuara Presidente Osmani-Sadriu,
I nderuar kryeministër Kurti,
I nderuari Komandant Jashari
Të nderuara familje të dëshmorëve, martirëve, invalidëve e veteranëve të UÇK-së,
Zv. kryeministra e ministra,
Të nderuar përfaqësues të shoqatave të luftës,
Të dashur ish-presidentë,
Të dashur përfaqësues të institucioneve tona shtetërore,
Kryetarë komunash,
Të dashur ambasadorë,
Mysafirë të pranishëm, zonja e zotërinj,
Lufta e Prekazit dhe sakrifica e Jasharajve, është ngjarje e pashembullt jo vetëm në historinë tonë kombëtare.

Një të ngjashme nuk e njeh as historia e botës.

Familja e gjerë Jashari, tre breza në kullën e tyre shekullore, në tokën e lashtë të stërgjyshërve, nga Baca Shaban e deri te Blerimi i vogël, e shpallën lirinë e popullit tonë dhe e mbrojtën atë deri në vetëflijimin e tyre të plotë.

Lufta ishte aq legjendare, sakrifica aq sublime, kurse vetëmohimi aq tronditës, sa që kombi shqiptar kaloi në një dimension tjetër të vetëdijes, kurse bota u zhvendos nga orbita e vet politike.

Ky është momenti kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës u bë frymë dhe e përfshiu të gjithë popullin tonë.

5, 6 dhe 7 marsi i vitit 1998 është kthesa kur sakrifica bëhet Epope.

Ne për liri kemi luftuar gjatë dhe gjatë historisë kemi dhënë shumë.

Por, lufta e Prekazit dhe rënia e Jasharajve është kondensimi i të gjitha përpjekjeve tona të pareshtura.

Ajo e përmban të gjithë mundin, vetëdijen kombëtare dhe gatishmërinë e të gjithë gjeneratave të mëparshme për liri.

Thuajse të gjitha ëndrrat e idealet tona qysh nga koha e Skënderbeut, të gjitha burgosjet, sakrificat, vuajtjet e vështirësitë nëpër të cilat kaluam, e pritën Adem e Hamëz Jasharin me prindërit, gratë, fëmijët dhe familjarët e tyre që ta kurorëzonin lirinë tonë.

Liria dhe pavarësia jonë u shpallën e u mbrojtën me gjak në ata metra katrorë të kullës së Jasharajve.

12 qershori dhe 17 shkurti janë kapituj të po atij libri monumental.

E të gjithë e dimë që, kur flasim për Jasharajt, lavdia e të gjallëve është jo më pakët se e të rënëve.

Besarta mbijetoi për ta ndarë me ne qëndresën legjendare dhe flijimin e familjes së saj.

Zoti u kujdes që dëshmia të jetojë.

Shpesh më del para syve momenti kur Baca Rifat kthehet në Prekaz mes varreve ende të freskëta.

Me plis në kokë dhe mustaqet e tij të bardha, në atë ecje titanike ai barte mbi supet e tij si kreshtat e maleve tona krejt dhimbjen tonë historike, por edhe krenarinë tonë më të lartë.

I kishte humbur 55 anëtarë të familjes, prej tyre gruan dhe 4 fëmijët e tij, prindërit e tij, vëllezërit bashkë me gratë e tyre dhe 9 nipa e mbesa.

Por, ishte ai që i ngushëllonte të tjerët, familjarët e gjallë, ushtarët e UÇK-së dhe bashkëfshatarët e tij.

Të dashur vëllezër e motra, vetëm për një minutë mundohuni, ju lutem, ta zini vendin e Bacës Rifat, dhe më thoni - a nuk është pikërisht ky definicioni i heroit tonë të gjallë.

Lavdi luftës dhe sakrificës së Familjes Jashari!

Lavdi Epopesë së UÇK-së!

Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Tash ia japim fjalën kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti. Urdhëroni, zoti Kurti!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: E nderuara Presidente e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani Sadriu,

I nderuari kryetar i Kuvendit, z. Glauk Konjufca,

I nderuari Baca Rifat Jashari,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,

zëvendëskryeministra e ministra të Qeverisë së Kosovës,

Shkëlqesi ambasadorë, diplomatë e miq ndërkombëtarë,

Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë e veteranë të luftës çlirimtare,

Të nderuar prijës fetar, udhëheqës e përfaqësues të institucioneve shtetërore,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

E hëna e sotme e këtij 6 marsi të vitit 2023, na ka mbledhur këtu në Kuvendin e Kosovës për ta përkujtuar Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në 25-vjetorin e saj, ashtu siç ka ngjarë atëherë dhe ashtu siç është trashëguar në vetë qenien tonë politike dhe shtetërore deri sot. Plot një çerekshkulli më parë, më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, mijëra forca të armatosura të Serbisë e rrethuan shumëfish Prekazin në një operacion policor që pas tre ditë luftimesh, rezultoi me 59 të vrarë.

Prej tyre, 20 anëtarë ishin vetëm nga familja e ngushtë e Shaban Jasharit, ku gjatë atyre tre ditëve u bë një rezistencë e armatosur e pashembullt, në një përballje krejtësisht të pabarabartë mes luftëtarësh të armatosur të lirisë dhe mijëra trupash të rregullta e speciale policore që po zbatonin një urdhër kriminal. Ishte hera e tretë që Familja Jashari sulmohej nga policia serbe dhe ishte hera e tretë që ajo rezistonte përballë trupave policore të Serbisë pushtuese.

Por, kësaj radhe, qëndresa e Familjes Jashari do të kthehej në rezistencë shembull që frymëzoi gjithë shqiptarët e Kosovës dhe kombin mbarë, për t'u çliruar nga Serbia dhe për të ndërtuar shtetin e Republikës së Kosovës në liri. Pas 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998, Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të rritej si një ushtri vullnetarësh në të cilën do të mobilizoheshin të gjithë ata që kishin vullnetin dhe guximin për të luftuar për çlirimin e Kosovës. Në historinë e UÇK-së dhe të Kosovës, rezistenca e Jasharëve të Prekazit dhe figura e Adem Jasharit janë themeltare dhe qendrore. E, të tilla do të mbeten përjetë!

Duke shënuar sot 25-vjetorin e Epopesë së UÇK-së, këtu nga foltorja e Kuvendit të Kosovës, do të doja ta rikthejë në vëmendje një episod nga viti i largët 1981 kur në atë kohë, në një ndejë pas demonstratave të vitit 1981, një profesor i angazhuar në ato demonstrata, i kishte thënë Shaban Jasharit këto fjalë: “Për gjashtë muaj do ta kemi

Republikën e Kosovës, o Shaban”. Kurse Shabani mendjemprehtë, që atë kohë ishte 57 vjeçar, ia kishte kthyer kështu: “Dëgjo more djalë, po u bë kjo puna e republikës sot e dhjetë vjet, do t’me dukej sikur me u ba sot”.

Teksa po parashikonin formimin e Republikës së Kosovës, atyre nuk mund tu ketë shkuar në mendje që 42 vite më vonë, kjo bisedë e tyrja do të përmendej pikërisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mes atyre dyve, koha do t’i jepte të drejtë shumë më shumë qëndrimit me maturi të bacës Shaban, sepse nga ajo kohë, do të duheshin të kalonin edhe shumë vite të përshkuara me aktivizëm dhe luftë, me sakrifica dhe flijime, deri te çlirimi i Kosovës dhe themelimi i republikës demokratike të saj që e kemi sot.

Ishte pikërisht ai vit, kur familja e Shaban Jasharit, veçanërisht pas rastit të rezistencës së Tahir Mehës në Prekaz, i hoqi dilemat për rrugën që duhej ndjekur dhe për domosdoshmërinë e luftës së armatosur për çlirimin e Kosovës. Një vit më pas, më 1982, dy djem të Shabanit, Rifati dhe Hamza, shkuan në Turqi për të marrë pamflete politike që më pas do t’i shpërndanin nëpër Kosovë. Në ato pamflete, shkruante: “Kosova Republikë”. Republika e Kosovës, si shtet demokratik nis me “Kosova Republikë”, si parullë popullore. Më shumë se katër dekada prej kohës kur kishte shpërndarë pamflete me thirrjen “Kosova Republikë”, Bacën Rifat Jashari e kemi këtu mes nesh, pikërisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

E kemi këtu për të kujtuar bashkë me krerët politikë të Kosovës, me deputetët e zgjedhur prej popullit në Kuvend si dhe me të gjithë qytetarët e vendit tonë, çfarë kishte ndodhur atëherë dhe çfarë kishte pasuar deri te marsi i vitit 1998 në Prekaz. Sepse familja e madhe që e krijuan Shaban Jashari dhe gruaja e tij Zahide Geci, ishte një shtëpi e ngritur mbi themele trashëgimisë patriotike siç ishte edhe një shkollë e formimit me atdhedashuri, që e mbanin si tre shtylla, tre djemtë e tyre: Rifati, Hamza dhe Ademi.

Hamza dhe Ademi do të binin dëshmorë në luftë për lirinë e Kosovës, në mars 1998, ndërkaq vëllait më të madh, Rifatit, do t’i takonte të vazhdonte rrugën e përbashkët të tyre, por edhe me një detyrë shtesë. Që nga marsi i vitit 1998, ky njeri, do të kryente detyrën e vështirë të ruajtjes së trashëgimisë me aq shumë vlera kombëtare dhe peshë historike të familjes Jashari. Për 25 vjet rresht, Baca Rifat Jashari ka pritur dhe përcjellë pa numër delegacione dhe mijëra e mijëra njerëz gjatë këtyre 25 vjetëve që e kanë vizituar Prekazin dhe Familjen Jashari.

Duke qëndruar sipas traditave më të fisme shqiptare, në krye të kullës, Rifat Jashari është kthyer në një hallkë të çeliktë që e ka ruajtur dhe e ruan të pathyer zinxhirin e gjatë të vazhdimësisë së Familjes Jashari, si dhe të gjithë asaj historie të lavdishme, heroike dhe

të pashembullt të Jasharëve të Prekazit, për të arritur me të gjitha vlerat dhe rëndësinë që ka deri në kohët e sotme.

Për këtë, në emrin tim si Kryeministër i Republikës së Kosovës, republikës së kësaj Kosove për të cilën bashkë me gjithë familjen ka vënë gjithçka në dispozicion nga fjala deri te jeta, dua që me përkulje respekti dhe me ndjesi admirimi, t'i them: Ju faleminderit Baca Rifat Jashari! Ju faleminderit që me kaq dinjitet dhe fisnikëri e keni ruajtur gjithë atë histori të familjes tuaj që ju e keni bërë bashkë me Hamzën dhe Ademin, me babën Shaban dhe nënën Zahide, dhe me gratë e familjes si dhe me vajzat e djemtë e tuaj.

Në këtë pikë, jam i nderuar që nga pozita e Kryeministrit të Kosovës, kam pasur fatin të udhëheq Komitetin Ndërmintor për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, i cili bashkë me Komisionin e Ekspertëve nga fusha të ndryshme profesionale, për më shumë se një vit, ka punuar dhe prodhuar materiale për studimin, hulumtimin, dokumentimin, restaurimin, rekonstruktimin dhe ndërtimin, që janë bërë dhe që do të bëhen në Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Qëllimi i këtij projekti, që është në fazën e shpalljes së konkursit ndërkombëtar, është që institucionet e Republikës së Kosovës, të investojnë në mënyrën e duhur, ashtu që pothuajse i gjithë fshati Prekaz, të shndërrohet në një peizazh kulturor historik, ku shqiptarët dhe të gjithë njerëzit do të mund të shkojnë për të parë jo vetëm vendin ku është jetuar dhe luftuar, por sidomos për t'u njohur me gjithë historinë e Jasharëve të Prekazit, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të vuajtjeve të shqiptarëve nën Jugosllavi dhe të luftës së paepur të popullit shqiptar për t'u çliruar nga Serbia.

Rezistenca e Jasharëve në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, nuk është edhe një degë më shumë në pemën rrënjëthellë të historisë moderne të Kosovës, por ajo është vetë trunгу i pemës së kësaj historie. Andaj, si një pemë farëmirë, le ta ruajmë për frutat e lirisë që na ka dhënë në të kaluarën dhe le ta kultivojmë për sythat e atdhedashurisë që presim prej saj për brezat e së ardhmes!

Lavdi Epopesë së UÇK-së dhe lavdi 59 të rënëve të 5, 6 dhe 7 marsit 1998 në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari në Prekaz, si dhe Lavdi secilës jetë njerëzore të dhënë për lirinë e Kosovës! Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Tash kësaj seance do t'i drejtohen edhe grupet parlamentare. Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, flet deputetja Shqipe Selimi.

SHQIPE SELIMI: E nderuara familje Jashari,
I nderuar Baca Rifat,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve dhe bashkëluftëtarë,
Të nderuar mysafirë në këtë seancë solemne,
E nderuara zonja presidente Osmani,
I nderuar kryetar i Kuvendit Konjufca,
I nderuar kryeministër Kurti dhe anëtarë të Qeverisë së Kosovës,
Të nderuar ushtarakë dhe oficerë të Policisë së Kosovës,
Të dashur deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të dashur qytetarë dhe bashkëkombës, kudo që jeni,
Jam shumë e nderuar që në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje të ndaj
bashkë me ju kujtimin dhe respektin për të gjithë dëshmorët e lirisë sot, në ditën e
përkujtimit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e 5, 6 dhe 7 marsit të '98-tës në historinë e
luftërave të shqiptarëve për liri, ashtu siç vet UÇK-ja dhe komandanti i saj legjendar
Adem Jashari, janë themeli, mburoja dhe simboli i Lirisë së Kosovës.

Prandaj, në këtë seancë solemne për nder të Epopesë së UÇK-së, Epopesë së Jasharajve,
kujtojmë dhe nderojmë luftën e UÇK-së, nderojmë luftëtarët e saj, kujtojmë dëshmorët e
rënë për liri, kujtojmë sakrificën e të gjithë popullit liridashës, kujtojmë të gjithë ata breza
që punuan dhe sakrifikuan për lirinë e atdheut. Në veçanti, sot i kujtojmë dhe nderojmë të
gjitha ato gra dhe fëmijë, ata djem e ata burra, që luftuan dhe ranë heroikisht në Prekazin
legjendar, përkrah komandantit legjendar, përkrah Hamzës e Bacë Shabanit, përkrah
Nënë Salës e Hamitit, përkrah Dajë Osmanit e gjithë luftëtarëve heronj, që gjakun e tyre e
vunë në themelet e Lirisë sonë, në themelet e këtij shteti që po e ndërtojmë për të ecur
sigurt deri në realizimin e plotë të idealit të dëshmorëve.

Të nderuar të pranishëm,

Të dashur qytetarë,

Lufta jonë çlirimtare ishte luftë e drejtë e popullit të Kosovës, ishte amaneti i Adem
Jasharit dhe ishte detyrë e jona si luftëtarë të UÇK-së të cilën detyrë ne e kryem me nderë
e krenari deri në fitore, dhe për këtë gjë jam shumë krenare që isha pjesë e asaj lufte me
pushkë në dorë e emblemë të UÇK-së në krah, bashkë me shumë bijë e bija të këtij
kombi. Marsi i Jasharajve dhe i UÇK-së tregon fuqishëm se lufta çlirimtare e Kosovës
nuk zhbëhet, nuk harrohet, nuk tjetërsohet e as nuk gjykohet. Ashtu sikur në çdo mars,
edhe sot populli i Kosovës e di ku i ka rrënjët liria, e di ku qëndron lavdia dhe si është
mbjellë ardhmëria. Prandaj edhe sot ashtu si gjithmonë le të jemi pranë familjeve të
dëshmorëve, e le të jemi me veteranët e invalidët e luftës që së bashku me brengat dhe
plagët e tyre ta nderojmë dhe kujtojmë luftën tonë të lavdishme.

Le të jemi sot pranë të gjithë atyre familjeve të të vvarëve dhe të të masakruarve dhe bashkë me ta të përballojmë dhembjen e tyre për familjarët e humbur në luftë. Le të jemi sot me familjarët e të pagjeturve nga lufta e fundit, që të marrim dhembje nga dhembja e tyre, që të marrim brengë nga brenga e tyre dhe të përmallohem nga malli i tyre.

Me përkushtimin dhe respektin ndaj atyre që dhanë gjithçka për lirinë e Kosovës, ne nderojmë më së miri luftën e Adem Jasharit. E nderojmë Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjithë luftën tonë çlirimtare. Me përkushtimin dhe nderimin ndaj së kaluarës sonë të lavdishme, ne ndërtojmë të ardhmen tonë të sigurt për gjeneratat e ardhshme. Lavdi Komandantit Legjendar, Adem Jashari, dhe të gjithë të rënëve në Epopenë e UÇK-së, më 5, 6 dhe 7 Mars 1998!

Lavdi gjithë të rënëve për liri!

Rroftë përjetë emri i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Tash Kuvendit i drejtohet kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: E nderuara Familje Jashari,
Shumë i respektuar Baca Rifat,
Të nderuara familje të dëshmorëve, të martirëve,
Invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
E nderuara presidente, zonja Osmani-Sadriu,
I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca,
I nderuar kryeministër, zoti Kurti,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,
Të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta,
Të nderuar oficerë të Ushtrisë së Kosovës, të Policisë së Kosovës,
Të nderuar mysafirë,
Zonja e zotërinj,
Në mars të vitit 1775, një nga etërit themelues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Patrick Henry zgjoi shpirtin liridashës e çlirimtar të popullit amerikan që u përhap gjithandej, në qendër të të cilit qëndronte thirrja e njohur historike: “Më jep liri, ose më jep vdekje!”.

“Liri a vdekje!” është një sentencë, që po aq origjinale është në rrugëtimin tonë historik, por ishte pikërisht marsi i vitit 1998 që këtë sentencë e nxori në një dimension të pakthyesëm, ku liria si kauzë dhe vdekja për liri dolën nga miti e u bënë realitet. Dhe, kjo ndodhi në Prekaz, në atë vend ku sot çdo shqiptar përkulet me nderim, pikërisht aty ku pushojnë më të denjë e Lirisë sonë.

U bë një çerek shekulli nga 5 marsi i vitit 1998, datë që ka ndryshuar përgjithmonë historinë e Kosovës dhe 25 vite pas aktit të flijimit për liri të Komandantit Legjendar Adem Jashari, të Bacës Shaban e Hamëz Jasharit, të burrave e grave, vajzave e djemve, të mbarë Familjes Jashari, atë që shënon Epopenë e UÇK-së në Liri e në shtetin tonë të pavarur e sovran mund dhe duhet ta shtrojmë për reflektim, me mendje të ftohtë, dimensionin e vërtetë të madhësisë së kësaj Epopeje.

Por, ndonëse sot mund të flasim e të reflektojmë me mendje të ftohtë dhe e kemi më të lehtë ta zbresim Epopenë e UÇK-së nga lavdia e fushëbetejave për liri në foltoren ceremoniale të Kuvendit, çdo 5, 6 dhe 7 mars. Emocionet tona ripërtërihen po aq sa edhe kuptimi e domethënia që i shoqëron këto data dhe në këtë domethënie që ripërtërihet ka disa të vërteta që na bëjnë nder sa herë që i themi.

Adem Jasharin para se ta nderojmë për luftën e sakrificën, duhet ta nderojmë për jetën dhe frymëzimin që i ka paraprirë asaj sakrifice. Para se ta marrim si nismëtarin e rrugës për çlirim, duhet ta marrim si vizionarin që vendosi themelet e vetëdijes, që nxiti e nisi drejt asaj rruge. Para se ta marrim si heroin që i ka dhënë kuptim një date të një kohe të shkuar, duhet ta marrim si heroin që i ka dhënë kuptim çdo kohe pas asaj date. I tillë ishte ai dhe të tillë ishin të gjithë ata që ndoqën rrugën e sakrificës sublime për Lirinë e Kosovës.

Prandaj sot, me zemër të plotë e me vetëdije të lartë dhe me përgjegjësinë që kemi ndaj së ardhmes, nderojmë e përkulemi para veprës së tyre heroike, mbi të cilën qëndron themeli i Kosovës së lirë e të pavarur. Natyrisht, kjo epope, krahas rrafshit të një kauze çlirimtare, nuk mund të ndahet edhe nga dimensionin e sakrificës së pashembullt njerëzore, që Familja Jashari kanë manifestuar përmes saj. Janë dhjetëra jetë që u martirizuan dhe për këto jetë të çmuara ia kemi borxh të pashlyeshëm Kosovës, një jetë më të mirë për fëmijët e së sotmes dhe të së ardhmes.

Një çerek shekulli nuk e ka shlyer aspak kujtesën e gjeneratave që kanë përjetuar ato ditë. Por ato ditë e tejkalojnë kujtesën e gjeneratave, sepse i takojnë një epoke historike, të cilën duhet t’ua mësojmë në mënyrë të drejtë gjeneratave që do të vijnë. Dhe, një histori e drejtë, e saktë për nga faktet, gjithëpërfshirëse për nga natyre dhe e qëndrueshme për nga e vërteta, mund të shkruhet vetëm kur i përgjigjemi pyetjes: Cili do të ishte fati i

Kosovës, po të mos kishte ndodhur sakrificat e Familjes Jashari dhe po të mos kishte qenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës?

Është e pamohueshme, se lëvizjet politike që lindën në vitet e '90-ta, që iu përgjigjën një nevojë dhe të drejte historike, si Liria dhe Pavarësia, i hapën popullit tonë një dritare shprese për Liri e Pavarësi. Por, Serbia nën regjimin e Milosheviqit ishte agresor që s'kuptonte, as gjuhën e paqes, as të dialogut, as të drejtësisë që natyrshëm i takonte vendit dhe popullit tonë.

Për afër një dekadë, përkundër që pati një konsistencë nga brenda, pati një status quo nga jashtë, prandaj dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i dha fund asaj status quo-je.

Pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nuk do të kishte pasur kurrë një Kosovë të lirë e të pavarur. Pa Adem Jasharin dhe Marsin e Lavdishëm të 98-tës, vështirë se do të kishte pasur një Ushtri Çlirimtare. Prandaj, vlera e kësaj Epopeje, nuk mund të kuptohet si një ngjarje në kuadrin e historisë, por si një epokë që i bën bashkë të gjitha ngjarjet. UÇK-ja e ka mbrojtur pragun e shtëpisë, por nuk ka luftuar vetëm për pragun e shtëpisë. Ka luftuar për kauzën tonë kombëtare shekullore. Ka luftuar për drejtësinë historike.

Dhe, madhështia e UÇK-së nuk e merr kuptimin e plotë pa sakrificën e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe të Familjes Jashari, që frymëzoi dhjetëra e mijëra djem e vajza për t'iu përgjigjur kushtrimit për çlirimin e vendit. Me këtë rast, në këtë ditë të lavdisë shembullore, na mungojnë bashkë-rrugëtuesit e Adem Jasharit, që nuk ju ndanë rrugës së tij deri në bërjen e Kosovës shtet të lirë e të pavarur, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, dhe bashkëluftëtarët e tyre, që të privuar nga liria, po mbahen larg nesh në betejën e fundit për të vërtetën e luftës së drejtë të UÇK-së.

Të nderuar të pranishëm,

Një çerek shekulli pas epopesë së UÇK-së, Kosova ende shumë punë të papërfunduara. 25 vjet pas, duhet të ngrihemi për të marrë përgjegjësitë që na takojnë përtej interesave të ngushta.

Adem Jashari nuk ka qenë njeri politik e as partiak, ai nuk i takon askujt veçanërisht, por na takon të gjithëve bashkërisht si shtet e si komb, të gjithë shqiptarëve kudo që janë, si frymëzim e si yll polar për të bërë punë të mira për vendin e për popullin tonë. Dhe, në këtë përkatësi të përbashkët që na lidh me emrin e tij e të familjes së tij, shtrihet edhe përgjegjësia jonë që të punojmë për një Kosovë më të mirë e më të drejtë me më shumë perspektivë për të rinjtë e ë rejtat e vendit tonë.

Për një Kosovë të tillë, Prekazin e kemi udhërrëfim. Për rrugën e cila nuk do të na shpie kurrë në qorrsokak. Lavdi e nderime të përjetshme për Familjen Jashari dhe për komandantin legjendar Adem Jashari! Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës! Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Tash kësaj seance i drejtohet kryetari i Lidhjes Demokratike, Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, znj. Osamni-Sadriu,

I kryetar i Kuvendit, zoti Konjufca,

I nderuar kryeministër Kurti,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

E nderuara Familje Jashari,

Shumë i respektuari, baca Rifat,

Të nderuar familje të dëshmorëve,

Veteranë e invalidë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Oficerë të Forcës së Kosovës, ushtrisë së Kosovës,

Të nderuar mysafirë të Korit diplomatik,

Zonja e zotërinj,

Të kujtosh e shënosh Epopenë e UÇK-së, do të thotë të kujtosh e shënosh vetë fundamentin e shtetit të Kosovës dhe përpjekjen tonë kolektive për liri. Do të thotë të kujtosh e shënosh sakrificën, qëndresën e vetë kushtrimin e popullit tonë të reflektuar në një familje të vetme, në atë që sot na qëndron si tempull pelegrinazhi për brezat e rinj, e që një çerek shekulli më parë na qëndronte si thirrje e rrugës sonë finale drejt lirisë.

25 vjet më parë mes thirrjeve monumentale të brezave nëpër histori, në Familjen Jashari, Adem Jashari, Hamëz Jashari, Shaban Jashari dhe 56 anëtarë të familjes, të afërm e bashkëluftëtarë ranë në altarin e lirisë, duke i dhënë vendit jo vetëm një histori sakrifice, por edhe një thirrje nacionale për përmbushjen e një rrugëtimi që nuk mund të ndalej më.

Qëndresa e tyre përballë forcave të shumta ushtarake e policore serbe, ishte zgjim i përbrendshëm për fatin tonë të shkruar tashmë nga një sakrificë që s'mund të kapërcehej asnjëherë. Dhe, pikërisht në qëndresë e në sakrificë të një ngjarjeje të vetme, por të madhe si kjo, qëndron edhe veçantia e marsit të vitit 1998 dhe të gjitha ngjarjeve të tjera që krijoi kjo epopë.

Në historinë e popullit të Kosovës nuk ka asnjë ngjarje tjetër që arrin të ofrojë dhembshurinë dhe krenarinë në të njëjtën kohë.

Mes gërmadhave të pragut të shtëpisë së Jasharajve, trupat e Blerinës 7-vjeçare, Fatimes 9-vjeçare, Igballes 11-vjeçare, e të gjithë fëmijëve e grave e të moshuarve të tjerë që s'ishin më, na qëndronin si monumente dhembjeje, si humbje të një familjeje që me këtë sakrificë sublime ishte bërë familje të gjithëve.

Mes të të njëjtave gërmadha në Prekaz, trupi i Ademit, biri i tretë i mësues Shabanit, dhe vëllait Hamzës, në gjithë pavdekshmërinë që kishin arritur atë ditë, na qëndronin si kreshnikë prijatar që kushtronin një thirrje që do të duhej ta dëgjonim të gjithë. Kjo thirrje e tyre u dëgjua gjithandej Kosovës.

Ajo u bë motiv i djemve dhe vajzave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që në rreshtimin më të madh historik të vendit u sakrifikuan në vetë themelin e shtetit tonë. Komandanti i rënë i tyre, kishte lënë ndjekës që do të ndërtonin historitë më të bukura të gjeneratës sonë.

Kjo thirrje e tyre u dëgjua edhe nëpër botë mes aleatëve tanë që në orët tona më të rënda na u gjenden në krah. Sepse Adem Jashari, familja e tij - siç do të thoshte presidenti Rugova - po e mbronin pragun e shtëpisë. Dhe, në gjithë shenjtërinë e mbrojtjes së pragut të shtëpisë qëndronte edhe bindja kokëforte e një populli të tërë për të kërkuar lirinë dhe vendin e barabartë mes popujve të tjerë nëpër me çdo çmim.

Një popull që e do lirinë - siç e donte Adem Jashari dhe familja e tij - do ta fitonte atë një ditë. Thirrja e Jasharajve vazhdon të dëgjohet edhe sot. Ajo na kumbon edhe sot në këtë sallë në këtë seancë. Ajo na vjen si rikujtim i përditshëm i obligimit tonë për vendin, barrën e trashëguar nga të tjerët para nesh, e trashëgiminë e domosdoshme që duhet ta lëmë tek të tjerët.

Ajo na vjen si thirrje për përbashkim të brendshëm, për atdhedashuri të pashtershme, e për angazhim të mbarë e të drejtë në çdo veprim tonin. Këtë liri, këtë shtet, të ardhmen si mundësi, e kemi si trashëgimi të shenjtë dhe të shtrenjtë të ndërtuar nga gratë dhe burrat më të mëdhenj të kohës.

Sot, në përvjetorin e 25-të të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kujtojmë e nderojmë të gjithë të rënë e lirisë, nderojmë të gjithë veteranët e invalidët e luftës sonë çlirimtare dhe secilin kontribuues në këtë rrugëtimin tonë triumfal. Nderojmë mbi të gjitha, familjen Jashari.

I nderuari baca Rifat, sot në Prekaz më the që dhimbjen e keni kapërcyer. Por, qëllimi i shuarjes së trungut tuaj familjar një çerekshekulli më parë ishte qëllim i shuarjes së vetë popullit shqiptar në Kosovë. Qëndresa juaj atëherë ishte rilindje e jona kombëtare. Rilindja juaj sot si familje, me breza të rinj e pasardhës të Jasharajve, është qëndresë që na mban në rrugën përpara.

Zoti e bekoftë familjen tuaj! Zoti i bekoftë të gjithë të rënë në altar të lirisë! Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës! Lavdi!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIAJ: E nderuara presidente e vendit,
I nderuar kryeparlamentar,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kor diplomatike dhe të gjithë sot që jeni këtu prezent,
Jo rastësisht pas gjithë këtyre përshëndetjeve, tani dua t'i përshëndes me nderimin dhe respektin më të madh, familjen e komandantit legjendar Adem Jashari, bacën Rifat. Përulemi para veprës sublime të familjes suaj.

Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e UÇK-së, të burgosurit politikë, familjet e të zhdukurve dhe të gjithë ata që në çfarëdo forme kontribuan që Kosova sot të jetë e lirë dhe e pavarur.

Përshëndet me nderimet më të larta ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po përballen me drejtësinë ndërkombëtare për të vërtetuar pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Urojmë që sa më shpejt të jenë në Kosovë për të cilën luftuan në familjet e tyre, në mesin e miqve dhe kolegëve të tyre.

Të nderuar të pranishëm,
Jemi mbledhur sot në 25-vjetorin e fillimit të luftës çlirimtare, atë që do ta quaj fillimi i fundit që ne sot e shënojmë si Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të treguar luftën dhe sakrificën heroike të komandantit legjendar Adem Jashari dhe gjithë familjes Jashari në Prekaz e në Drenicë.

Datat 5,6 dhe 7 mars të vitit 1998 janë data të kthesës historike dhe lavdisë së shqiptarëve të Kosovës dhe jo vetëm këto data shënojnë fillimin e fundit të një kapitulli shekullor në okupim.

Epopeja e UÇK-së kulmoi pas përpjekjeve shekullore të shqiptarëve të Kosovës për liri. Breza të tërë u angazhuan dhe kontribuuan në forma dhe mënyra të ndryshme për të ardhur deri te liria.

Kujtojmë dhe nderojmë sot gjenerata të tëra që me guxim protestuan me vite kundër regjimit dhe okupimit serb, dhe respektojmë sot ata që humbën jetën përgjatë atyre përpjekjeve, nderojmë me qindra intelektualë, atdhetarë e patriotë që u dergjen burgjeve të okupatorit vetëm që kërkon liri dhe pavarësi.

Më pas, më 5 dhe 6 mars të vitit 1998, forcat serbe rrethuan shtëpinë ku gjendej komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja e tij, me tanke dhe artileri të rënda. Në përlëshjet që vazhduan për tri ditë radhazi, pas një lufte heroike si në legjenda, ku luftonte një familje kundër një shteti okupator me gjithë artileritë e tij, në një rezistencë tashmë të njohur botërisht, forcat serbe vranë dhe masakruan mbi 56 anëtarë të familjes Jashari në mesin e të cilëve edhe gra e fëmijë.

Një familje si në legjenda luftoi me trimëri e heroizëm, me pushkë dhe këngë deri në plumbin e fundit, duke mos rënë asnjë i gjallë në dorën e armikut. Ashtu siç do të thotë edhe autori në këngë, kur e pyesin Besartën deri kur i ke parë, ajo thotë: “Kur u ndal kënga, e kam ditur që janë vranë”. Për familjen Jashari kënga nuk do të ndalet asnjëherë.

Aty ranë heroikisht për të mos vdekur kurrë. Ai që do të mbetet i gjallë gjithmonë është komandant Adem Jashari. Emri i tij ngriti në këmbë një kombe të tërë dhe u bë sinonim i luftës për liri dhe pavarësi. Lufta dhe sakrifica e Jasharëve mobilizoi shqiptarët në gjithë andej botës për t’u bashkuar në luftën për liri.

Tani nuk ishte vetëm Prekazi e Drenica, por e gjithë Kosova, ku mijëra qytetarë po armatoseshin për t’iu bashkuar luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila e bëri realitet lirinë dhe pavarësinë e popullit tonë.

Se lufta e Adem Jasharit dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë e tregoi fakti se krah i kësaj dhe aleatë të tyre u bënë shtetet më të fuqishme dhe demokratike të botës në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e NATO-s.

Sot, falë luftës dhe sakrificës të komandantit legjendar Adem Jashari, Familjes Jashari dhe luftës e sakrificës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kosova është e lirë, shtet i pavarur dhe sovran.

Këto kanë bërë që Prekazi, kulla dhe varrezat e Jasharajve janë shndërruar në një vend pelegrinazhi për shqiptarët në përgjithësi, por edhe për vizitorët e personalitetet e huaja, të cilat shtangën nga kjo histori.

Nëse ka diçka shumë të vlefshme që duhet të mburren e të krenohen fort shqiptarët kudo që janë, e veçmas shqiptarët e Kosovës, është Ushtria Çlirimtare e Kosovës si kurorëzim i të gjitha sakrificave të patriotëve të tërë që e nxorën hakun për vuajtjet e të gjitha gjeneratave të tëra për liri e pavarësi.

Lavdi komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes heroike Jashari! Lavdi luftës dhe sakrificës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! I përjetshëm qoftë kujtimi për të gjithë ata që u bënë gurthemel i lirisë dhe pavarësisë. Faleminderit përjetësisht Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Në emër të Grupit Multietnik ia japim fjalën kryetarit të këtij grupi, Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit!

Shumë i nderuar baca Rifat,

E nderuar Familja Jashari,

E nderuara presidente Osmani,

I nderuar kryetar i Kuvendit, Konjufca,

I nderuar kryeministër Kurti,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ambasadorë,

Të nderuar familje të dëshmorëve dhe shoqatave,

Të nderuar pjesëmarrës,

Sot jemi mbledhur në këtë seancë për ta përkujtuar sakrificën e Familjes Jashari, peshën historike të ngjarjeve të 5, 6, 7 marsit të vitit '98.

Ne përkujtojmë dhe e nderojmë sakrificën e të gjithë atyre që e dhanë jetën për shtetin, për lirinë dhe për paqen. Populli i Kosovës kishte nevojë për shumë mund dhe vështirësi

për ta arritur lirinë. Ai pësoi dhembje dhe humbje. Ishte lufta çlirimtare që e solli fitoren e Kosovës sonë, e cila po përparon me hapa të fortë e të sigurt.

Beteja e Familjes Jashari u shndërrua në inspirim për rininë që edhe ata të jenë të gatshëm për të ofruar çdolloj sakrifice për të jetuar të lirë. Ekzistenca e ushtarëve dhe dëshmorëve tanë si komunitete joshumicë në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është shembulli më i mirë për këtë dhe është një tregues se ne kemi një histori dhe fat të përbashkët.

Sot, në rruhen që na e kanë lënë amanet ata, ne e kemi ndërtuar shtetin demokratik, shtetin e së drejtës, shtet gjithëpërfshirës me të drejta të garantuara kushtetuese për të gjithë qytetarët e tij.

Rruga deri këtu nuk ishte e lehtë, por deri këtu erdhëm gjithë së bashku. Dhe, aspak e lehtë nuk do të jetë ditët që na presin, as angazhimi që po na pret deri në arritjen e qëllimeve kryesore për shtetin tonë, për fëmijët tanë dhe për brezat tanë të ardhshëm pa dallim, duke lënë mënjanë edhe dallimet politike, sot më shumë se kurrë kemi nevojë të jemi të bashkuar për atdheun për amanetin e Adem Jasharit dhe gjithë dëshmorëve na sollën këtë liri, sepse Republika e Kosovës është dhe do të jetë gjithmonë shtet i pavarur për të gjithë ne.

Epopeja na dëshmoi se çdo gjë vetëm së bashku është e mundur. Prandaj, për të arritur një Kosovë të suksesit të përbashkët me aleatët tanë strategjikë, ne komunitetet joshumicë do të vazhdojmë të ofrojmë mbështetjen dhe kontributet tona të pafundshme për ta ndërtuar dhe fuqizuar shtetin tonë.

Me këto ndjenja dhe dëshira, edhe njëherë e falënderojmë dhe e përkujtojmë komandantin Adem Jashari, Familjen Jashari dhe të gjithë dëshmorët, të zhdukurit dhe heronjtë që na e bënë atdheun tonë të pavarur, shtet ku ka vend për të gjithë ne. Lavdi për të gjithë dëshmorët!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Për një fjalë përshëndetëse për këtë seancë ia japim fjalën Bacës Rifat Jashari.

(Duartrokitje)

RIFAT JASHARI: Faleminderit!

Ju rritë ndera!

E nderuar kryetare e shtetit,

I nderuari kryetar i Parlamentit,

Kryeministër i Republikës së Kosovës,

Mysafirë të nderuar,

Deputetë e deputete të këtij Kuvendit,

Sot jemi bashkuar këtu në 25-vjetorin e Epopesë ë Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

E di që u fol që ka edhe ambasadorë e të tjerë, e me këtë rast i përshëndes të gjithë.

Duke i falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe bijat dhe bijtë tanë, ne sot kemi arritur këtu jemi të lirë që t'i qajmë hallet me njëri-tjetrin. Shtetet e Bashkuara dhe shtetet mike i kemi pranë nesh. Edhe ju ushtarë të nderuar e oficerë, se ju shikova njëherë por më humbi! I falënderoj nënat e dëshmorëve, motra, veteranët, invalidët, familjarët e personave të zhdukur, të gjithë juve. Ju uroj shëndet, Lavdi e nder të gjithë atyre që ranë!

Këtu është Kuvendi ku merren vendimet për të ardhmen e vendit, për të ardhmen e shtetit. Ju kisha preferuar që të jeni të një gjuhe, të një qëndrimi dhe ta kalojmë këtë sfidë që e kemi përpara. Të ndahemi njëherë e përgjithmonë nga Serbia, e tani kemi kohë të merremi me të tjerat. Ju falënderoj! Shëndet e të gjitha të mirat!

KRYETARI: Duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrje, por në veçanti Bacën Rifat dhe anëtarët e Familjes Jashari, e mbyllim këtë seancë solemne.

Mirupafshim në seancat e tjera. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*